



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT**

Nr.2017/1 prot.

Tiranë më 05.12.2022

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.4552/3 Prot., datë 23.11.2022, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Planit të Veprimit dhe pasaportës së indikatorëve”* së bashku me relacionin shpjegues, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shpreh dakortësinë për masën dhe aktivitetin përkatës të propozuar, për realizimin e të cilave, do të jetë përgjegjës institucioni ynë.

Ndërkohë, në dokumentin *“Matrica e masave dhe aktiviteteve të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026”*, me qëllim saktësimin e disa elementëve, sugjerojmë që aktiviteti 1.1.10.1, të riformulohet si vijon: *“Fushatë kombëtare ndërgjegjësuese me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrativ)”*.

Sugjerimi i mësipërm është dërguar edhe në rrugë elektronike.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi